




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 490 / 18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z., Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Merimanga”N.T.SH -Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës,ku për kontratë është rekomanduar OE-“Dreni-A”shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “ Shërbimet e transportit me Merimangë” me numër të prokurimit :616-18-4235-211 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë”, më datën 25.10.2018 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Merimanga”N.T.SH -Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Shërbimet e transportit me Merimangë” me numër të prokurimit :616-18-4235-211 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK - “KK-Prishtinë”,

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së “KK-Prishtinë”, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “ Shërbimet e transportit me Merimangë” me numër të prokurimit :616-18-4235-211 dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Merimanga”N.T.SH -Prishtinë aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 13.06.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 16.07.2018

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit e eliminuar: 27.08.2018

Data e njoftimit për dhënien e kontratës:27.08.2018

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Merimanga”N.T.SH -Prishtinë me dt: 31.08.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 04.09.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “Merimanga”N.T.SH -Prishtinë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Merimanga”N.T.SH -Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 14.09.2018 me nr. 487 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Shërbimet e transportit me Merimangë” me numër të prokurimit :616-18-4235-211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,58 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.09.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 01.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: "Merimanga" N.T.SH -Prishtinë në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Pretendime të operatorit ekonomik Ankues "Marimanga" N.T.SH Pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë "DRENI-A" SH.P.K ka bërë shkelje të afatit kohor të dorëzimit të ofertave në ora 14,3 minuta. Eksperti shqyrtues duke u bazuar në Regjistrin e tenderëve të dorëzuar që mban datën 16.07.2018, shijet se në këtë dëshmi janë të renditur 4 operator ekonomik me Nr rendor 1,2,3,4. Tek numri rendor 4 është renditur OE DRENI-A SH.P.K ku shijet se data e dorëzimit të ofertave 16.07.2018 si dhe ora kur është dorëzuar kjo ofertë figuron ora 14:00 ofertave, është evidentuar se oferta e OE "DRENI-A" SH.P.K, është dorëzuar në ora 14:00. Po ashtu në këtë dëshmi tek vija Vertikale në fund të pjesës së nënshkrimit të dorëzuesit të tenderit është nënshkruar po në këtë vit por unë nuk jam institucion kompetent për të vërtetuar se kjo ofertë është dorëzuar pas orës 14:00 sepse nuk kemi ndonjë dëshmi që e vërteton këtë. Eksperti shqyrtues Lidhur me pretendimin e OE Ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar deklaratën mbi specifikacionet teknike të detyrueshëm dhe deklaratë mbi mbulueshmërinë e pjesëve (Loteve) në aktivitetin e prokurimit në fjalë, Konstaton se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës paramanën e ka të vulosur dhe të nënshkruar, e që pretendimet e ankuesit janë të paqëndrueshëm. AK nuk mund ta diskualifikoj një operator ekonomik për kërkesat të cilat nuk janë të vendosur në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK ka vendosur kërkesën diskriminuese në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-se në të mirë të një OE tek kërkesat mbi mundin teknike dhe profesionale ka vendosur kërkesa të pa qarta si në vijim "OE duhet të ofroj dëshmi se ka minimumi 2 vozitës dhe 2 ndihmës që kanë patentë shoferin e kategorisë përkatëse për drejtim të automjetit përkatës ndërsa nuk ka bërë specifikimi se a ka kërkuar patentë shoferin për shoferë apo vetëm për ndihmës, Eksperti shqyrtues konstaton se në pajtim me Nenin 108/A të LPP-se Operatorët ekonomik të cilët konsiderojnë se AK ka vendosur kërkesa diskriminuese apo në kundërshtim me dispozitat e LPP-se mund të parashtroj Ankesë në fazën e ofertimit e jo një gjë të tillë ta bëjë pas njoftimit të dhënies të kontratës.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të Refuzohet (për arsytet që u cekën tek përgjigjet në pretendimet ankimore), dhe të mbetet në fuqi Vendimi i AK / njoftimi për dhënie të kontratës.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 01.10.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 01.10.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.10.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, Eksperti shqyrtues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Hasani deklaroi: Un jam drejtor i OE Merimanga. Un vet kam dorëzuar tenderin në AK pasi ky tender përmban mbi 60% të punës së përgjithshme të OE. Andaj për neve ky tender është jetik për të mbijetuar si kompani. Ankesa jonë kundër shpalljes së fituesit është për arsyet në vijim. Tenderi i OE të rekomanduar për kontratë Dreni shpk është dorëzuar me vonesë pas orës 14:03. Edhe pse në kërkesë ka qenë që deri në ora 14:00 të pranohet të gjitha ofertat. Vet personalisht kam dorëzuar tenderin për OE Merimanga në 13.50. Pas meje tenderin ka dorëzuar OE Besa Cola. Ne kemi qëndruar së bashku me përfaqësuesin e OE Besa Cola në hollin në zyre pranuese, në momentin kur zyrtarja komunale na ka thënë se është kryer dhe mundini të ngjiteni lart pas orës 14:03 se është mbyllur pranimi i ofertave. Si duket pas orës 14:03, pasi ka pas vonesa gjatë hapjes pasi nuk ka funksionuar interneti, kanë shkuar 15 deri 20 minuta dhe ka filluar hapja diku në ora 14:30.

Ndërkohë sa kemi pritur të bëhet hapja dhe kompletimi i zyrtarëve komunal, në dhomën e hapjes ka mbërri edhe OE Dreni. Ne dorëzojmë dëshmi se momentin kur na ka dërguar lartë zyrtarja e komunës rubrikën e ka mbyllur tek numri 4 (katër). Ndërkohë pasi që ka mbërri kompania Dreni ajo është shënuar mbi vizën e kufizuar ku mbyllet tenderi me tre ofertues. Me gjithë se ky tender ka pas mundësi të bëhet online, neve nuk kemi reaguar pasi kemi pritur thjesht që është ofertues edhe online. Mirëpo ndërkohë zyrtarja ka arritur me katër zarfi dhe në at moment nuk kemi reaguar. Pasi është bërë hapja jam konsultuar me juristin dhe më ka thënë të parashtroj ankesë në AK të cilët e kemi bërë me formular standard për ankesa. Gjatë bisedës me zyrtaren komunale znj Sebahate Canolli dhe shefin e sektorit të pranimi të dokumenteve Nefi, më kanë të Thënë se ajo është dorëzuar pas (pas kohës së dorëzimit). Në bisedë me zyrtarin i njëjti ka thënë se ka pranuar ofertën pasi i ka ardhur keq. Mirëpo me këtë jemi dëmtuar ne si OE. Së bashku me zyrtarin në fjalë z. Nefi i kam thënë të shkojmë dhe ti tregojmë z. Zekë Bardhaj se OE ka dorëzua tenderin pas orës 14:00. Në atë moment z.Bardhaj më thotë se është dashtë të ankohemi para

se të bëhet hapja, me gjithë se siç potencova ka qenë moment se nuk kemi ditur si të veprohet për momentin. Fatkeqësisht kemi shpresuar se fjalët e menaxhmentit të komunës së Prishtinës se këta kanë të drejtë dhe keqpërdorimet i trajtojnë me prioritet dhe seriozitet, mirëpo jo edhe në rastin tonë siç shihet. Në fund ju lus të shqyrtoni edhe nga një kënd tjetër këtë çështje, nëse afati i dorëzimit është 14:00. atëherë i kjo i bie që tenderi duhet të dorëzohet në ora 13 ora 59 minuta e 59 sekonda. Për neve kjo është një e padrejtë që na është bërë neve si kompani dhe kompanive tjera pjesëmarrëse. Duhet ti drejtohem ekspertës së OSHP që nuk është marr me trajtimin e çështjes, por mundohet të lenë si normale mbylljen e procesverbalit dhe fakteve që kemi cekur, duke arsyetuar se nuk është eksperte për këtë çështje. Mirëpo nuk ngritët ndonjë fakt si duhet të trajtohet kjo çështje, si psh duke kërkuar video incizim ku kamerat gjenden në gjitha korridoret e KK Prishtinë, pasi zakonisht ruhen incizimet deri në 2 muaj kohë ndërsa një zyrtar në komunë më ka thënë se në komunë ruhen deri në 6 muaj. Çështja duhet që duhet potencuar është kërkesa e komunës për leje në kategorinë C, për shoferët por edhe për ndihmësit. Në tender në FDT është kërkuar që kompania duhet të ketë minimum dy shofer dhe dy ndihmës mirëpo edhe ndihmësi të ketë lejen e kategorisë C. Nga përvoja shumë e gjatë që kemi, ndihmësi ka punë dhe përgjegjësi tjera dhe nuk e ka punën e shoferit. Ne kemi shofer të tjerë të mjaftueshëm që nuk i kemi shënuar për ndihmës në këtë rast .E kisha lut panelin të shqyrtoj ankesën dhe të anulohet tenderi në tërësi.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj.Dalipi deklaroi:AK pajtohet me raportin e ekspertit në tërësi. Duhet të shtoj disa pika, hapja e tenderëve është bërë në përputhje me nenin 58. Në zyre të prokurimit kanë ardhur 4 oferta nga zyra pritëse (Sportelet), po ashtu në regjistrin e tenderëve të dorëzuar shënon se OE Dreni ofertën ka dorëzuar në ora 14:00. Ne kemi bërë hapjen në formë të rregullt. Ndërsa lidhur me kërkesën teknike OE ankues është i përgjegjshëm sepse nuk ka patentën përkatëse për drejtim të automjetit përkatës për shoferët ndihmës. Në këtë aktivitet vetëm një OE ka qenë i përgjegjshëm dhe është më i lirë të cilin e kemi rekomanduar për kontratë, andaj bazuar në nenin 18.4, kur nuk ka tender të përgjegjshëm të mjaftueshëm për të shpërblyer gjitha lotet, mbizotëron interesi i AK-së që të shpërblej të gjitha lotet. Pra në mungesë të konkurrentëve tjerë, OE shpërblehen për më shumë lote se numri maksimal i përcaktuar nga AK. Kërkoj që ankesa e OE të hedhet si e pabazuar dhe të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit.

Ne pyetjen e anëtarit të panelit drejtuar përfaqësuesit të AK-së, se a është kërkuar decidivisht leja e kategorisë C për shoferit ndihmës.

Përfaqësuesi i AK-se znj. Dalpi jep këtë përgjigje: PO, kërkesë ka qenë "OE duhet të ofroj dëshmi se ka minimum dy vozitës dhe dy ndihmës që kanë patentën e shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës".

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese deklaroj: Sipas dokumenteve që kam pas në dispozicion, oferta e OE "Dreni" shënon se është dorëzuar në ora 14:00, andaj edhe konstatimi im është dhënë konform këtyre dokumenteve. Sa i përket çështjes për patentë shofer për ndihmësit, kërkesë e AK-së ka qenë patentë shofer të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës. Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në ekspertizë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Ankues "Marimanga" N.T.SH, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë "DRENI-A " SH.P.K ka bërë shkelje të afatin kohor të dorëzimit të ofertave, ku ka dorëzuar ofertën në ora 14,3 minuta. Paneli shqyrtues sqaron se OSHP-ja, ka kërkuar nga autoriteti kontraktues KK Prishtinë që të na dërgohen minimumi pesë (5)–Regjistër të tenderëve të dorëzuar, të vitit 2018 që kanë të bëjnë me aktivitet të ndryshme të prokurimit. Autoriteti kontraktues –AK, i ka dorëzuar në OSHP-së, pesë (5) –Regjistër të tenderëve të dorëzuar, e që vërehet se ka dallime në mes të pesë –Regjistërëve të tenderëve të dorëzuar nga AK-ja, nga Regjistri i tenderëve të dorëzuar dt.16.07.2018, që ka të bëjë me ankesën nr.490/18 të cilin ankuesi pretendon se emri i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës është shënuar në këtë regjistër pas orës 14:00. Paneli shqyrtues konstaton se Dallimi në mes të Regjistërëve të tenderëve të dorëzuar vërehet në këto pika: tek –Regjistri i tenderëve të dorëzuar të dt.16.07.2018, shihet se vija mbyllëse e dorëzimit të tenderëve është në rubrikën/kolonën e njëjte me emrin e operatorit të fundit që ka dorëzuar ofertën, gjë që nëse e krahasojmë me pesë Regjistrat të tenderëve të dorëzuar tjerë shihet se në koto pesë–Regjistrat të tenderëve të dorëzuar, vija mbyllëse e tenderëve të dorëzuara është një kolonë mbas emrit të operatorit të fundit që ka dorëzuar tenderin.

Dallimit tjetër ndërmjet këtyre–Regjistrave të tenderëve të dorëzuar është se në asnjërin nga pesë–Regjistrat të tenderëve të dorëzuar, të dorëzuar në OSHP nuk e kemi ndonjë vije mbyllesë e ofertave të dorëzuara mbi nënshkrimin e operatorit të fundit që ka dorëzuar tenderin, (e që në –Regjistër të tenderëve të dorëzuar të dt.16.07.2018 vija mbyllëse e dorëzimit të tenderëve është në nënshkrimin e

përfaqësuesit të OE “DRENI-A”SHPK).

Paneli shqyrtues sqaron se krahasimi i Regjistrave të tenderëve të dorëzuar, është bërë duke u thirrur në këto Prova:—1. Regjistri i tenderëve të dorëzuar, i dt. 16.07.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “ Shërbimet e transportit me Merimangë” me numër të prokurimit :616-18-4235-211; 2. Regjistri i tenderëve të dorëzuar, i dt. 06.06.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria” me nr. Te prokurimit:616/18026511; 3. Regjistri i tenderëve të dorëzuar i dt.02.02.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull”Furnizim për zyre me material të shtypur dhe material tjera me nr te prokurimit:616/18 003 121; 4. Regjistri i tenderëve të dorëzuar, te dt.17.09.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asfaltimi i rrugës Matiqan,Butovc, Kolovicë me nr. Te prokurimit:616 18 061 512; 5. Regjistri i tenderëve të dorëzuar, i dt.19.04.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Deratizimi i podrumëve dhe garazheve publike në qytetin e Prishtinës dhe deratizimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prishtinës” me numër të prokurimit:616 18 36 211; 6. Regjistri i tenderëve të dorëzuar, i dt.12.06.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ofrimi i shërbimeve për organizim, manifestim kulturor rinor....”me nr te prokurimit:616 18 3082 221.

Paneli shqyrtues në bazë të sqarimeve të dhëna si më lart konstaton se për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e transportit me Merimangë” me numër të prokurimit :616-18-4235-211, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë, në pajtim me nenin 130 të LPP-së, do të kërkoj nga institucionet kompetente që të vazhdojnë me tutje lidhur me procedurat e kësaj lende.

Paneli shqyrtues Lidhur me pretendimin e OE Ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar deklaratën mbi specifikacionet teknike të detyrueshëm dhe deklaratë mbi mbuleshmërin e pjesëve (Lloteve)në aktivitetin e prokurimit në fjalë ,konstaton se autoriteti kontraktuese me rastin e rivlerësimit duhet të bëjë vlerësimin e ofertave në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se AK-ja ka vendosur kërkesën diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së në dem a në të mirë të një operatori ekonomik, paneli shqyrtues konstaton se për kërkesa diskriminuese apo favorizuese operatorët ekonomik në pajtim me 108/A të LPP-së, duhet të parashtroj ankese gjatë fazës tenderuese e jo një gjë të këtilla ta parashtrojnë në këtë fazë të një aktiviteti të prokurimit. Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK-ja duhet të veproj në pajtim me nenin 7 të LPP-së dhe të trajtoj ofertuesit në mënyrë të barabartë sa i përket kërkesës së cekur si më lart. Duke pasur parasysh faktin se tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale AK-ja ka specifikuar

edhe këtë kërkesë : “OE duhet te ofroj dëshmi se ka minimumi 2 vozitës dhe 2 ndihmës që kanë patën shoferin e kategorisë përkatëse për drejtim të automjetit përkatës ndërsa nuk ka bërë specifikimi se a ka kërkuar patetshoferin për shoferë apo vetëm për ndimsa.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran MILENKOVIC



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK-Prishtinë”,
- 1x1 OE- “Merimanga”N.T.SH -Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.